

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t, FIER**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Fier, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datë 31.06.2015, me objekt:“ Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.06.2013 deri më 30.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 74, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 269/8, datë 05.07.2015, i ka rekomanduar z. Artan Lame, Drejtor i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, në të cilën përfshihet Drejtoria Rajonale e ALUIZNI Fier, zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Konstatohet se në 11 raste, megjithëse ndërtimet informale nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, nga administrata e ALUIZNI-t Fier nuk është zbatuar asnjë procedurë ligjore për s’kualifikimin e tyre, veprime këto në kundërshtim me pikën 5 të nenit 2 dhe nenin 39, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, Kapitulli IV të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, urdhrit nr. 291 datë 01.09.2008, urdhrit nr. 846 datë 11.10.2012, si dhe pika 2 dhe pika 3 germa “ a ” e nenit 42, të VKM nr. 40, datë 11.01.2012.

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa që 11 ndërtimet informale, të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim të ndiqen procedurat për s’kualifikimin e tyre, deri në hartimin e listave për IMKT Dega Fier.

**2. Gjetje nga auditimi:** Dosjet e subjekteve të pajisur me leje legalizimi, janë pa inventar të rregullt dhe kalimi i tyre nga një sektor në tjetrin, si dhe dërgimi në Drejtorinë Qendrore nuk shoqërohet me inventar të rregullt, veprime këto në kundërshtim me pikën 1.1 të nenit 7, neni 8, pika “ç” e nenit 10, neni 12 dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe pika 2,3, 6 dhe 8.4, të Rregullores së Brendshme të ALUIZNI-t Qendror..

**Rekomandimi:** Drejtori i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, të nxjerr urdhër të brendshëm për kryerjen e inventarizimit fizik dhe elektronik të gjithë dosjeve dhe dokumentacionit që administrohet dhe kalimi i dosjeve nga sektori në sektor të bëhet me procesverbal të administruar me numër protokolli dhe inventar.

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në genplanet (hartën fushore) e paraqitura nuk evidentohet hyrja për në parcelën ndërtimore dhe relacioni tekniko-ligjor nuk është në përputhje me ligjin, veprime këto në kundërshtim me nenin 32, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“ dhe pikës 1.3, të urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 “Për miratimin e manualit “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet“, i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa që në praktikën e legalizimeve në genplan të përcaktohet hyrja për në parcelën ndërtimore dhe relacioni tekniko-ligjor të jetë në përputhje me dispozitat ligjore.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi, është konstatuar se dhënia e lejeve të legalizimit të ndërtimeve informale, është bërë në kundërshtim me neni 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, pasi lejet e legalizimit janë dhënë jashtë afatit ligjorë (nga 2 muaj deri në 3 vjet).

Gjithashtu, janë evidentuar raste, ku megjithëse është i plotësuar i gjithë dokumentacioni ligjorë, akoma lejet e legalizimit nuk i janë dhënë subjekteve për vijimin e procedurave të mëtejshme ligjore, regjistrimi në ZVRPP .

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masat që lejet e legalizimit të cilat plotësojnë kriteret për legalizim të lëshohen brenda afatit 30 ditore të përcaktuar në ligj ose në rast se nuk plotësojë kriteret ligjore të ndiqen procedurat për s'kualifikimin e tyre, si objekte në kundërshtim me ligjin.

**5. Gjetje nga auditimi:** Në 34 raste, legalizimi i ndërtimeve informale është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, pasi ndërtimet informale janë në prona me pronarë (të bashkisë, private etj), për të cilën ZVRPP nuk kanë vijuar procesin e regjistrimit të tyre për shkak mbivendosje të pronës.

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa për saktësimin e pronës të objekteve të legalizuar dhe plotësimin me dokumentacion të nevojshëm ligjorë për regjistrimin në ZVRPP Fier. Në rast mos plotësimi të kërkesave ligjore të zbatohen procedurat për skualifikimin e tyre.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në **13 raste** legalizimi i ndërtimeve informale, është bërë në zona të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, *konkretisht:*

-**Në 1 (një) rast**, ndërtimi informal është legalizuar *pranë kanalit ujitës* dhe pa dokumentacionin e plotë ligjorë, veprime këto në kundërshtim germën “dh” dhe “ë” pika 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, duke cenuar sistemet dhe brezin mbrojtës të kanalit kullues, me germën “ç” e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin” .

-**Në 7 raste**, ndërtimet informale nuk *kanë ruajtur distancat e lejuar me strukturën e rrugës*, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, pika 2 e nenit 1, germa “b” e pikës 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 994, datë 06.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, si dhe vendimit nr. 16, datë 10.05.2013 të KKT “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Ndërvendor të Bashkisë Fier dhe Komunës Qendër, Qarku Fier (sipas PPV të miratuar me vendim nr. 24, datë 09.07.2012 të Këshillit Bashkiak Fier dhe vendimit nr. 33, datë 26.07.2012 të miratuar në Këshillin e Komunës Qendër).

-**Në 3 raste**, ndërtimet informale janë legalizuar në *zona me rrezik përmbajtje*, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, me ndryshime, ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe Planin e Përgjithshëm Ndërvendore të Bashkisë Fier dhe Komunës Qendër, miratuar me Vendim të nr. 24, datë 09.07.2012 të Këshillit Bashkiak Fier (KB) dhe Vendim nr. 33, datë 26.07.2012 të Këshillit Komunës Qendër.

-**Në 1 (një) rast**, ndërtimi informal është legalizuar *pranë lumit Gjanica*, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, germa “i” dhe “ii” e pikës 3, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, nenin 84, të ligjit nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, si dhe vendimit nr. 24,

datë 09.07.2012 të Këshillit Bashkiak Fier "Plani i Përgjithshëm Ndërvendore të Bashkis Fier".

**-Në 1 (një) rast,** ndërtimi informal është legalizuar *pranë nënstacionit të Naftës*, veprime këto në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, VKM nr. 438, dt. 28.06.2006, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objekte në ndërtim, që legalizohen ose jo", Pika 2/e(ii) sipas të cilës: "Nuk kualifikohet për legalizim objekti i ndërtuar pa leje, ose shtesa e sipërfaqes tej lejes së miratuar, që është ngritur brenda territoreve dhe kufirit mbrojtës të zonave të mbrojtura, me akte, ligjore dhe nënligjore, si zonë e mbrojtur, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për ndërtimet informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ato që kanë lidhur kontratat, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se në **77 raste** janë evidentuar **20060.98 m<sup>2</sup>** sipërfaqe parcelë ndërtimore të zaptuara dhe në posedim nga poseduesit, konfirmuar kjo me procesverbal konstatimi, genplaneve, hartës fushore dhe vektoriale të pronësive paraqitur në autocat (vënë në dispozicion nga drejtoria e AULIZNI<sup>t</sup>, Fier), sipërfaqe të cilat janë zvogëluar për efekt mos pagese të vlerës së trullit të zaptuar, megjithëse në krah të këtyre parcelave ekzistojnë pjesë parcele të pa legalizuara të cilat janë pjesë përbërëse të parcelës ndërtimore, por që janë numërtuar si parcele më vete dhe sëbashku do të rezultonin sipas sipërfaqes së vetëdeklaruar dhe konstatuar në terren me procesverbal konstatimi. Gjithashtu bie në sy mos konfigurimi i saktë i parcelës ndërtimore, ku nuk janë lënë rrugët hyrëse për në parcelë dhe se parcela e legalizuar ndodhet në mes të parcelës së madhe, duke i bërë të pashfrytëzueshme pjesët që e rrethojë parcelën e legalizuar, pasi ato nuk mund të shfrytëzohen për vetë pozicionin gjeografik që ato ndodhe, veprime këto në kundërshtim me pikat 1 dhe 2, e urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008 "Hartimi dhe paraqitja grafike (gen-plan, ortofoto, planimetri), të objektit që legalizohet", i ndryshuar, germa "f" dhe "g" e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

Vlera e parcelës ndërtimore të palegalizuar paraqitet prej **159,179,921 lekë**, nga e cila; pagesë me bono privatizimi në vlerën 79,972,370 lekë dhe pagesë me vlerë leku shumë 79,207,551 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit për Fondin e kompensimit të ish-pronarëve.

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa dhe të ndjek procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit e parcelës ndërtimore për korrigjimin e kontratave të shitjes së trullit në **77 raste** me sipërfaqen **20060.98 m<sup>2</sup>**, për të cilën është arkëtuar më pak vlera prej **159,179,921 lekë**, si diferencë e pagesës së sipërfaqes së parcelës ndërtimore të paguar me sipërfaqen e parcelës ndërtimore të vetëdeklaruar dhe konstatuar me procesverbal, të cilën poseduesi i ndërtimit informal e administron në fakt, në bashkëpunim dhe me NJQV dhe ZVRPP-në.

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi inventarizimin e pronës shtetërore për vitet 2013-2014, konstatohet se nuk janë hartuar procesverbalet për fiksimin e fletë-hyrjes dhe fletë-daljes së fundit, procesverbalet në përfundim të inventarizimit, pasqyrat diferenciale për sistemimin e diferencave, si dhe mungojnë raportet përfundimtarë të komisionit të inventarizimit, veprime këto në kundërshtim me pikat 83, 85/b,c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier (Sektori i Financës), të marrë masa lidhur me kryerjen e inventarizimit të pronës shtetërore, për hartimin e procesverbaleve për fiksimin e fletë-hyrjes dhe fletë-daljes së fundit, procesverbaleve në përfundim të

inventarizimit, pasqyrave diferenciale për sistemimin e diferencave dhe raporteve përfundimtarë të komisionit të inventarizimit.

**10. Gjetje nga auditimi:** Në 8 raste, lejet e legalizimit, procesverbalet e konstatimit, aktet e kualifikimit, etj, janë nënshkruar nga disa drejtorë dhe punonjës në emër të personave të tjerë, të paautorizuar, ku ka edhe nënshkrime që nuk identifikohen dot, veprime këto në kundërshtim me nenet 80 dhe 81, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar .

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm në procesin e legalizimit, lejet e legalizimit, procesverbalet e konstatimit, aktet e kualifikimit, etj, konformë dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi, legjislacionit për kryerjen e procedurave administrative, me rregullsi dhe pa gabime, duke eliminuar procedurat e gabuara të nënshkrimit në emër të punonjësve të tjerë dhe të paautorizuar dhe arkivisti të mos konfirmojë, vulosë dhe inventarizojë dosje me dokumentacion jo të rregullt.

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga poseduesit e ndërtimeve informale të pajisur me leje legalizimi, nuk janë llogaritur dhe paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë, kjo për 1319 raste me vlerë 40,007,618 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshimesh me ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” .

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier në bashkëpunim me njësite vendoret Qarkut Fier, të marrë masa për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve të taksës së infrastrukturës në **1319 personave me vlerë 40,249,516 lekë**, të cilët nuk kanë bërë të mundur likuidimin e kësaj takse.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **33,284,139 lekë në 52 persona/raste**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e bilancit financiar (debi kredive), konstatohet se sipas të dhënave të pasqyruara në pasiv të bilancit të vitit 2013, në llogaritë “Detyrime afatshkurtra”, përveç detyrimeve të tjera është pasqyruar edhe detyrimi për “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” me vlerë 7,516,385 lekë, e cila përfaqëson; *detyrimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit të papaguara në vitin 2009 në vlerën 3,205,668 lekë, kamatëvonesa për mospagimin në afat në vlerën 2,641,365 lekë, dhe gjoba në vlerën 1,669,352 lekë.*

Ndërsa në llogarinë “Detyrime për tatim-taksa”, paraqitet vlera 2,719,724 lekë, e cila përfaqëson; *tatimin mbi të ardhurat personale të ndalura të punonjësve për vitin 2009, por të padredhura në organet tatimore në vlerën 1,483,882 lekë, kamatë-vonesën për mos derdhjen në afat të tyre 780,750 lekë dhe gjoba me vlerën 455,092 lekë.*

Mos derdhja në afat e detyrimeve, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9146, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8438, 28.12.1998, “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos derdhjen në afat i këtyre detyrimeve që nga viti 2009, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier janë llogaritur kamatëvonesat dhe gjobat, duke shkaktuar një dëm buxhetit të këtij institucioni në vlerën **5,546,559 lekë, shumë kjo që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik.**

Të gjithë këto detyrime të vitit 2009, që kapin vlerën 10,236,107 lekë, detyrime këto të përcaktuara me shkresën nr. 1355, datë 02.02.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, janë likuiduar nga kjo Drejtori në muajin Shkurt 2015 me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 554/2, datë 23.01.2015 “Akomodim i fondeve në zbatim të Vendimit nr. 15, datë 09.01.2015 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura” .

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, nëpërmjet sektorit të financës, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **5,546,559 lekë, ndajë ish-punonjësve;**

**1. z. I.H** me detyrë ish-drejtor për vlerën 1,386,640 lekë;

**2. z. G.H** me detyrë ish-drejtor për vlerën 1,386,640 lekë;

**3. z. A.Z** me detyrë ish-specialit finance për vlerën 1,386,640 lekë;

**4. znj. M.T** me detyrë ish-specialit finance për vlerën 1,386,639 lekë;

të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë sjellë si pasojë shkeljen e disiplinës financiare, duke tejkaluar pa ligjshmërisht shpenzimet buxhetore me pagesat e kryera për gjokat dhe kamatë-vonesat, si shkaktarë të dëmit të konstatuar.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në **48 raste**, tarifa e parcelës ndërtimore nuk është llogaritur në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, VKM nr. 309, datë 15.09.2008 "Për zbatimin e procedurave të përcaktuara në manualin "Për mënyrën e llogaritjes dhe plotësimit e formularëve për pagesën e detyrimeve financiare të procesit të legalizimit", si dhe VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna", i ndryshuar, pasi llogaritja e vlerës së parcelës ndërtimore është bërë referuar VKM<sup>së</sup> nr. 187, datë 06.03.2013 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë", duke evidentuar një vlerë parcelë ndërtimore të pallogaritur **prej 27,737,580 lekë**, nga e cila; *me bono privatizimi vlera 13,868,790 lekë dhe me lekë vlera prej 13,868,790 lekë*, si dëm ekonomik në buxhetin e shtetit për fondin e kompensimit të ish pronarëve .

**Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier, të marrë masa për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e detyrimeve të tarifës së parcelës ndërtimore në **48 raste me vlerë 27,737,580 lekë**, nga e cila; *me bono privatizimi vlera 13,868,790 lekë dhe me lekë vlera prej 13,868,790 lekë* dhe të ndjek të gjitha procedurat e duhura administrative në të gjitha shkallët e gjykimit.

**3.** Për të gjithë emrat e evidentuara në pikën 2, të njoftohet ZVRPP dhe ZQRPP të marrë masa për vendosjen e barrës (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit për tu nxjerrë.

## **C. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, **t'i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, që bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga **"Vërejtje"** deri në **"Zgjidhjen e Kontratës së Punës"**, për 5 punonjësit e mëposhtëm:

### **1. Z. E.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht*;

-mos plotësimin e të dhënave të regjistrit elektronik, sipas kërkesave të urdhrit nr. 291 datë 01.09.2008 dhe urdhrit nr. 846 datë 11.10.2012, si dhe VKM nr. 437 datë 28.06.2006.

-mos kryerjen e inventarit të rregullt dhe kalimin e dosjeve nga një sektor në tjetrin, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", neni 7, pika 1.1, neni 8, neni 10, pika "ç", neni 12 dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme të ALUIZNI<sup>t</sup>, pika 8.4 (sektori i arshivës dhe protokollit, pika 2,3 dhe 6).

-mos zbatimin e procedurave ligjore, në s'kualifikimin e ndërtimeve informale të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 39 dhe neni 42, VKM nr. 40 datë 11.01.2012, pika 2 dhe pika 3, germa " a ", **evidentuar në 11 raste**.

-mos zbatimin e procedurave ligjore, në legalizimin e ndërtimeve informale në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo", i ndryshuar, pasi ndërtimet informale bien në prona me

pronarë (të bashkisë, private etj), për të cilën ZVRPP nuk ka vijuar procesin e regjistrimit të tyre për shkak mbivendosje të pronës .

-mos lëshimin e lejeve të legalizimit brenda afatit 30 ditorë, siç përcaktohet në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar .

-mos zbatimin e nenit 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshimesh me ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, mbi mënyrën e llogaritjes, dokumentimit dhe arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-në 31 raste, kemi parcelizim të parcelës ndërtimore, duke lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcele ndërtimore të zaptuara nga poseduesi dhe konfirmuara me procesverbal konstatimi, ku vlera e tarifës së parcelës ndërtimore të pallogaritur paraqitet prej 66,981,910 lekë, si mungesë të ardhurash në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime këto në kundërshtim me urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 “Hartimi dhe paraqitja grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të ndërtimit që legalizohet”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 74-142, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **2. Z. R.H, me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Legalizim e Urbanizimit të Drejtorisë Rajonale të ALUZIONI-t Fier.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht*;

-mos plotësimin e të dhënave të regjistrimit elektronik, sipas kërkesave të urdhrin nr. 291 datë 01.09.2008 dhe urdhrin nr. 846 datë 11.10.2012, si dhe VKM nr. 437 datë 28.06.2006.

-mos kryerjen e inventarit të rregullt dhe kalimin e dosjeve nga një sektor në tjetrin, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, neni 7, pika 1.1, neni 8, neni 10, pika “ç”, neni 12 dhe 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme të ALUZIONI-t, pika 8.4 (sektori i arshivës dhe protokollit, pika 2,3 dhe 6).

-mos zbatimin e procedurave ligjore, në s’kualifikimin e ndërtimeve informale të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, neni 39 dhe neni 42, VKM nr. 40 datë 11.01.2012 pika 2 dhe pika 3 germa “ a ”, **evidentuar në 11 raste.**

-mos zbatimin e procedurave ligjore, në legalizimin e ndërtimeve informale në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, pasi, ndërtimet informale bien në prona me pronarë (të bashkisë, private etj), për të cilën ZVRPP nuk ka vijuar procesin e regjistrimit të tyre për shkak mbivendosje të pronës .

-mos lëshimin e lejeve të legalizimit brenda afatit 30 ditorë, siç përcaktohet në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar .

-mos zbatimin e nenit 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshimesh me ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, mbi mënyrën e llogaritjes, dokumentimit dhe arkëtimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-në 31 raste, kemi parcelizim të parcelës ndërtimore, duke lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcele ndërtimore të zaptuara nga poseduesi dhe konfirmuara me procesverbal konstatimi, ku vlera e tarifës së parcelës ndërtimore të pallogaritur paraqitet prej 66,981,910 lekë, si mungesë të ardhurash në fondin e kompensimit të ish-pronarëve, veprime këto në kundërshtim me urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 “Hartimi dhe paraqitja grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të ndërtimit që legalizohet”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006.

### **3. Z. A.DH, me detyrë specialit në sektorin e urbanizimit të Drejtorisë Rajonale të ALUZIONI-t Fier.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht*;

**-në 1 (një) rast**, kualifikimi dhe miratimi lejes së legalizimit është ***bërë pranë kanalit ujitës dhe pa dokumentacionin e plotë ligjorë***, veprime këto në kundërshtim germën “dh” dhe “ë” e pikës 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, duke cenuar sistemet dhe brezin mbrojtës të kanalit kullues, me germën “ç” e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin”

**-në 2 raste**, kualifikimi dhe miratimi lejeve të legalizimit nuk plotësojnë kriteret e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, pika 2 e nenit 1, germa “b” e pikës 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, germa “iii” e pikës 1, të VKM nr. 871, datë 27.12.2006, pikën 3.6.4, të urdhrin nr. 46, datë 18.07.2006, nenin 40, të VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të territorit”, si dhe vendimit nr. 16, datë 10.05.2013 të KKT “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Ndërvendor të Bashkisë Fier dhe Komunës Qendër, Qarku Fier (sipas PPV të miratuar me vendim nr. 24, datë 09.07.2012 të Këshillit Bashkiak Fier dhe vendimit nr. 33, datë 26.07.2012 të miratuar në Këshillin e Komunës Qendër), ***pasi objektet informale nuk kanë ruajtur distancat e lejuar me strukturën e rrugës.***

**-në 1 (një) rast**, kualifikimi dhe miratimi i lejes së legalizimit është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, germa “i” dhe “ii” e pikës 3, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar, nenin 84, të ligjit nr. 111/2012, datë 15.12.2012 “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, si dhe vendimit nr. 24, datë 09.07.2012 të Këshillit Bashkiak Fier “Plani i Përgjithshëm Ndërvendore të Bashkis Fier”, ***pasi objekti është i pozicionuar pranë lumit Gjanica .***

**-në 38 raste**, kemi parcelizim të parcelës ndërtimore, duke lënë jashtë procesit të legalizimit sipërfaqe parcele ndërtimore të zaptuara nga poseduesi dhe konfirmuara me procesverbal konstatimi, ku vlera e tarifës së parcelës ndërtimore të pallogaritur paraqitet prej **106,458,405 lekë**, veprime këto në kundërshtim me urdhrin nr. 291, datë 01.09.2008 “Hartimi dhe paraqitja grafike (genplan, ortofoto, planimetri), të ndërtimit që legalizohet”, i ndryshuar, si dhe shkronja “f” dhe “g” e nenit 3 dhe pika 1 e nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku si rezultat i mos legalizimit të këtyre sipërfaqeve të zaptuara, në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 .

### **4. Znj. D.M, me detyrë specialiste e llogaritjes së faturave në Drejtorinë Rajonale të ALUZIONI-t Fier.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht*;

**-mos zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”, i ndryshuar, në llogaritjen e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore, evidentuar në **10 raste me vlerë 2,688,304 lekë .****

### **5. Znj. H.D, me detyrë specialiste e llogaritjes së faturave në Drejtorinë Rajonale të ALUZIONI-t Fier.**

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *konkretisht*;

-mos zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe VKM nr. 1620, datë 26.11.2008 "Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna", i ndryshuar, në llogaritjen e vlerës së tarifës së parcelës ndërtimore, evidentuar në **1 rast me vlerë 1,435,648 lekë**.

Nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI Fier, është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi e zbatimi**.

**Shënim:** Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Kristaq Gjurgjaj, Hysen Metko, Ramadan Zejnuni dhe Aleksander Papadhimitri, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT